2017	60 257	15.9	43.3	151 815	5.0	31.1	-91 559
2018	68 252	18.6	13.3	206 492	6.2	36.0	-138 241
2019	67 378	17.6	-1.3	223 899	6.4	8.4	-156 521
2020	110 231	23.2	63.6	190 980	5.8	-14.7	-80 749
2021	111 329	14.7	1.0	266 858	5.7	39.7	-155 528
2022	101 962	11.1	-8.4	255 862	4.5	-4.1	-153 900
2023	114 869	13.3	12.7	328 267	5.5	28.3	-213 398

Figura 11: Paraqitja grafike me Shqipërinë



Produktet kryesore me Shqipërinë


Kodi	Eksportet në Shqipëri KSTJ (REV4)	2022	2023	%	2023/2022
112	Pije alkoolike	9,095	13,232	11.5	1.5
111	Pije joalkoolike të pa s.d.t.	6,937	10,968	9.5	1.6
282	Mbeturina dhe copëza me përmbajtje hekuri	17,466	7,232	6.3	0.4
679	Gypat, tubat dhe profilet e shtrira, pajisje për gypa ose tuba	4,364	6,782	5.9	1.6
288	Mbetje dhe kthime me baze metali jo-ferrike te pa s.d.t.	6,100	4,334	3.8	0.7
821	Mobiljet dhe pjesët e ndërlidhura, shtretërit, dyshekë	3,092	3,838	3.3	1.2
582	Pllaka, fleta, film, dhe stripe, të plastikës	2,498	3,243	2.8	1.3
893	Artikuj të plastikës të pa s.d.t.	2,000	3,241	2.8	1.6
001	Kafshë të gjalla përveç kafshëve të ndarjes në kreun 03	856	3,105	2.7	3.6
691	Strukturat dhe pjesët e struk. hekuri, çeliku ose alumini	1,077	2,990	2.6	2.8
	Të tjera	48,477	55,905	48.7	1.2
	Total eksportet	101,962	114,869	100.0	1.1
Kodi	Importet nga Shqipëria KSTJ (REV4)	2022	2023	%	2023/2022
676	Shufra hekuri dhe çeliku, kallam, këndet, format dhe pjesët	111,830	126,277	38.5	1.1
661	Gëlqere, cement, material ndërtimor i fabrikuar	24,606	38,045	11.6	1.5
351	Rryme elektrike	16,360	35,933	10.9	2.2
054	Perime të freskëta, ftohta, ngrira ose konservuara	10,326	14,359	4.4	1.4
111	Pije joalkoolike të pa s.d.t.	6,583	14,195	4.3	2.2
335	Produktet e mbetura të naftës, të pa s.d.t.	5,191	12,931	3.9	2.5
533	Pigmente (ngjyrues i fortë), ngjyra, materiale lustruese etj.	8,279	10,153	3.1	1.2
057	Pemët dhe lajthitë të freskëta ose të thara	7,876	9,917	3.0	1.3
642	Letër dhe kartonë prej letre	8,760	9,717	3.0	1.1
691	Strukturat dhe pjesët e struk. hekuri, çeliku ose alumini	4,968	8,681	2.6	1.7
	Të tjera	51,084	48,059	14.6	0.9
	Total importet	255,862	328,267	100.0	1.3

Tab. 19: Qarkullimi i mallrave me Maqedoninë e Veriut në periudhën 2013 - 2023

(në mijë Euro)

Vitet	Eksporti	%	Ndryshimi	Importi	%	Ndryshimi	Bilanci tregtar
2013	26 139	8.9	-0.9	185 020	7.6	-35.7	-158 880
2014	35 960	11.1	37.6	139 668	5.5	-24.5	-103 708
2015	33 355	10.3	-7.2	143 846	5.5	3.0	-110 490
2016	38 578	12.5	15.7	156 727	5.6	9.0	-118 149
2017	45 850	12.1	18.9	156 498	5.1	-0.1	-110 647
2018	43 737	11.9	-4.6	172 176	5.1	10.0	-128 440
2019	44 125	11.5	0.9	240 641	6.9	39.8	-196 516
2020	44 082	9.3	-0.1	188 589	5.7	-21.6	-144 508
2021	86 984	11.5	97.3	242 785	5.2	28.7	-155 801
2022	119 083	12.9	36.9	282 060	5.0	16.2	-162 977
2023	121 589	14.1	2.1	310 879	5.3	10.2	-189 290

Figura 12: Paraqitja grafike me Maqedoninë e Veriut



Produktet kryesore me Maqedoninë e Veriut


Kodi	Eksportet në Maqedoni e veriut KSTJ (REV4)	2022	2023	%	2023/2022
282	Mbeturina dhe copëza me përmbajtje hekuri	23,052	22,740	18.7	1.0
679	Gypat, tubat dhe profilet e shtrira, pajisje për gypa ose tuba	15,003	15,592	12.8	1.0
322	Briketa, linjitit	2,302	9,313	7.7	4.0
351	Rryme elektrike	7,755	8,383	6.9	1.1
111	Pije joalkoolike të pa s.d.t.	5,627	8,259	6.8	1.5
582	Pllaka, fleta, film, dhe stripe, të plastikës	6,013	5,012	4.1	0.8
288	Mbetje dhe kthime me baze metali jo-ferrike te pa s.d.t.	8,447	4,730	3.9	0.6
821	Mobiljet dhe pjesët e ndërlidhura, shtretërit, dyshekë	3,643	3,815	3.1	1.0
642	Letër dhe kartonë prej letre	2,160	2,459	2.0	1.1
071	Kafe dhe prodhimet e kafes	2,789	2,207	1.8	0.8
	Të tjera	42,294	39,079	32.1	0.9
	Total eksportet	119,083	121,589	100.0	1.0
Kodi	Importet nga Maqedonia e veriut KSTJ (REV4)	2022	2023	%	2023/2022
351	Rryme elektrike	31,916	49,219	15.8	1.5
334	Vaj naftë dhe vajrat e nxjerra nga mineralet e bitumenit	58,078	36,712	11.8	0.6
661	Gëlqere, cement, material ndërtimor i fabrikuar	24,704	27,521	8.9	1.1
111	Pije joalkoolike të pa s.d.t.	2,661	21,332	6.9	8.0
048	Përgaditjet nga drithërat dhe përgatitjet nga mielli	13,882	15,941	5.1	1.1
674	Prodhimet nga hekuri të petëzuara ose celik pa aliazh	17,525	13,935	4.5	0.8
893	Artikuj, të pa s.d.t., prej plastike	9,438	9,796	3.2	1.0
		8,903	6,619	2.1	0.7
582	Pllaka, fleta, film, dhe stripe, të plastikës	8,903	6,619	2.1	0.7
542	Medikamentet (përfshirë medikamenteve veterinare)	5,557	6,443	2.1	1.2
663	Mineral manufactures, n.e.s.	6,054	6,193	2.0	1.0
	Të tjera	103,341	117,167	37.7	1.1
	Total importet	282,060	310,879	100.0	1.1

Tab. 20: Qarkullimi i mallrave me Gjermaninë në periudhën 2013 - 2023

(në mijë Euro)

Vitet	Eksporti	%	Ndryshimi	Importi	%	Ndryshimi	Bilanci tregtar
2013	10 985	3.7	-26.7	252 594	10.3	-17.0	-241 609
2014	11 340	3.5	3.2	272 973	10.8	8.1	-261 633
2015	11 693	3.6	3.1	290 948	11.0	6.6	-279 255
2016	13 830	4.5	18.3	342 890	12.3	17.9	-329 060
2017	20 194	5.3	46.0	378 515	12.4	10.4	-358 321
2018	24 872	6.8	23.2	394 143	11.8	4.1	-369 270
2019	30 907	8.1	24.3	447 645	12.8	13.6	-416 738
2020	43 980	9.3	42.3	427 065	13.0	-4.6	-383 084
2021	61 769	8.2	40.4	611 365	13.1	43.2	-549 596
2022	87 767	9.5	42.1	610 440	13.1	-0.2	-522 673
2023	93 598	10.8	6.6	757 519	12.8	24.1	-663 921

Figura 13: Paraqitja grafike me Gjermaninë



Produktet kryesore me Gjermaninë


Kodi	Eksportet në Gjermani KSTJ (REV4)	2022	2023	%	2023/2022
893	Artikuj, të pa s.d.t., prej plastike	25,223	24,402	26.1	1.0
821	Mobiljet dhe pjesët e ndërlidhura, shtretërit, dyshekë	9,567	8,844	9.4	0.9
691	Strukturat dhe pjesët e strukturave, prej hekuri, çeliku ose alumini	4,939	6,742	7.2	1.4
811	Objekte te parafabrikuara	3,814	4,739	5.1	1.2
699	Prodhimet e metaleve bazë të pa s.d.t.	4,119	3,637	3.9	0.9
693	Produkte nga teli dhe thurje skare	4,024	3,195	3.4	0.8
292	Mobiljet dhe pjesët e ndërlidhura, shtretërit, dyshekë	2,411	2,937	3.1	1.2
658	Artikuj te punuar, tërësisht ose kryesisht i mat tekstilit	2,804	2,372	2.5	0.8
781	Automjetet dhe veturat për transportin e udhëtareve	2,804	2,173	2.3	0.8
056	Perimet, rrënjët dhe zhardhokët, përgatitur ose ruajtur	1,875	2,092	2.2	1.1
	Të tjera	26,187	32,464	34.7	1.2
	Total eksportet	87,767	93,598	100.0	1.1
Kodi	Importet nga Gjermania KSTJ (REV4)	2022	2023	%	2023/2022
781	Automjetet dhe veturat për transportin e udhëtareve	226,483	338,654	44.7	1.5
782	Automjete për transportimin e mallrave	35,147	41,334	5.5	1.2
583	Monofilament të cilit çdo dimension kryq seksional i kalon 1 mm, shufra, shkopinj	35,025	31,741	4.2	0.9
098	Produkte ushqimore te pa s.d.t	16,909	22,338	2.9	1.3
122	Duham, i fabrikuar (dhe elemente duhani zëvendësuese)	15,377	16,279	2.1	1.1
024	Djathë dhe gjizë	15,874	15,917	2.1	1.0
553	Parfumeri, kozmetike dhe preparate tualeti	12,198	15,074	2.0	1.2
723	Pajisje civile inxhinierike	7,628	13,468	1.8	1.8
783	Automjetet rrugore, te pa s.d.t	10,744	12,541	1.7	1.2
022	Qumshtë, yndyrë dhe prodhime prej qumështi	8,498	11,327	1.5	1.3
	Të tjera	226,556	238,845	31.5	1.1
	Total importet	610,440	757,519	100.0	1.2

Tab. 21: Qarkullimi i mallrave me Italinë në periudhën 2013 - 2023

(në mijë Euro)

Vitet	Eksporti	%	Ndryshimi	Importi	%	Ndryshimi	Bilanci tregtar
2013	74 363	25.3	4.2	228 519	9.3	7.1	-154 156
2014	49 660	15.3	-33.2	203 068	8.0	-11.1	-153 408
2015	19 568	6.0	-60.6	226 476	8.6	11.5	-206 908
2016	5 727	1.8	-70.7	202 819	7.3	-10.4	-197 092
2017	6 341	1.7	10.7	194 722	6.4	-4.0	-188 380
2018	7 800	2.1	23.0	205 495	6.1	5.5	-197 696
2019	22 602	5.9	189.8	222 487	6.4	8.3	-199 885
2020	28 721	6.0	27.1	185 761	5.6	-16.5	-157 041
2021	60 186	8.0	109.6	276 395	5.9	48.8	-216 209
2022	46 370	5.0	-23.0	275 883	4.9	-0.2	-229 514
2023	38 664	4.5	-16.6	308 029	5.2	11.7	-269 365

Figura14: Paraqitja grafike me Italinë



Produktet kryesore me Italinë


Kodi	Eksportet në Itali KSTJ (REV4)	2022	2023	%	2023/2022
582	Pllaka, fletë, film, fletë metalike dhe shirita, prej plastike	15,859	6,693	17.3	0.4
554	Përgatitjet për pastrim dhe lustrim të sapunit	4,115	6,014	15.6	1.5
893	Artikuj, të pa s.d.t., prej plastike	3,558	5,179	13.4	1.5
111	Pije joalkoolike të pa s.d.t.	1,545	2,725	7.0	1.8
654	Pëlhura të tjera tekstili, të endura	2,912	2,407	6.2	0.8
845	Artikujt e veshjeve, të pëlhurave tekstile, të thurura ose të thurura	1,148	2,357	6.1	2.1
811	Prefabricated buildings	2,214	1,289	3.3	0.6
851	Këpucë	920	1,270	3.3	1.4
691	Strukturat dhe pjesët e struk. hekuri, çeliku ose alumini	1,887	1,198	3.1	0.6
695	Mjete për përdorim në dorë ose në makineri	1,883	1,188	3.1	0.6
	Të tjera	10,330	8,344	21.6	0.8
	Total eksportet	46,370	38,664	100.0	0.8
Kodi	Importet nga Italia KSTJ (REV4)	2022	2023	%	2023/2022
334	Vaj naftë dhe vajra e nxjerra nga mineralet e bitumenit	16,034	21,852	7.1	1.4
098	Produkte ushqimore të pa s.d.t	18,219	20,111	6.5	1.1
728	Makineri dhe pajisje të tjera të specializuara për industri të veç	10,144	17,172	5.6	1.7
071	Kafe dhe prodhimet e kafes	11,562	13,390	4.3	1.2
048	Përgatitjet nga drithërat dhe përgatitjet nga mielli	10,644	12,100	3.9	1.1
542	Barnat (përfshirë barnat veterinare)	7,453	10,750	3.5	1.4
676	Shufra hekuri dhe çeliku, kallam, këndet, format dhe pjesët	6,989	10,219	3.3	1.5
553	Parfumeri, kozmetike dhe preparate tualeti	7,508	9,171	3.0	1.2
662	Materiale ndertimore prej argjile	11,898	9,005	2.9	0.8
664	Xham	6,207	6,996	2.3	1.1
	Të tjera	169,226	177,262	57.5	1.0
	Total importet	275,883	308,029	100.0	1.1

Tab. 22: Qarkullimi i mallrave me Serbinë në periudhën 2013 - 2023

(në mijë Euro)

Vitet	Eksporti	%	Ndryshimi	Importi	%	Ndryshimi	Bilanci tregtar
2013	14 463	4.9	-3.4	285 356	11.7	2.5	-270 892
2014	27 292	8.4	88.7	368 234	14.5	29.0	-340 941
2015	32 262	9.9	18.2	382 129	14.5	3.8	-349 868
2016	41 331	13.3	28.1	387 647	13.9	1.4	-346 316
2017	48 246	12.8	16.7	449 918	14.8	16.1	-401 672
2018	33 529	9.1	-30.5	388 928	11.6	-13.6	-355 398
2019	27 361	7.1	-18.4	5 784	0.2	-98.5	21 577
2020	30 522	6.4	11.6	174 029	5.3	2 909.1	-143 507
2021	44 265	5.9	45.0	306 354	6.5	76.0	-262 089
2022	62 896	6.8	42.1	372 065	6.6	21.4	-309 169
2023	49 642	5.8	-21.1	198 736	3.4	-46.6	-149 094

Figura15: Paraqitja grafike me Serbinë



Produktet kryesore me Serbinë

Kodi	Eksportet në Sërbia KSTJ (REV4)	2022	2023	%	2023/2022
679	Gypat, tubat dhe profilet e shtrira, pajisje për gypa ose tuba	18,431	14,363	28.9	0.8
058	Fruta, të ruajtura, dhe përgatitjet e frutave	3,716	2,860	5.8	0.8
582	Pllaka, fletë, film, peta dhe rripa, prej plastike	3,270	2,533	5.1	0.8
335	Produktet e mbetura të naftës, të pa s.d.t., dhe materialet e lidhura	5,272	1,998	4.0	0.4
893	Artikuj, të pa s.d.t., prej plastike	2,058	1,879	3.8	0.9
635	Përpunimi i drurit, të pa s.d.t.	2,116	1,556	3.1	0.7
421	Vajra dhe yndyra vegjetale, të përpunuara	56	1,513	3.0	27.1
764	Pajisjet e telekomunikacionit, të pa s.d.t., dhe pjesët, aksesoret e aparateve	1,641	1,405	2.8	0.9
111	Pije joalkoolike të pa s.d.t.	927	1,343	2.7	1.4
211	Lekure e papërpunuar (përveq gëzofeve)	1,666	1,265	2.5	0.8
	Të tjera	23,745	18,926	38.1	0.8
	Total eksportet	62,896	49,642	100.0	0.8
Kodi	Importet nga Sërbia KSTJ (REV4)	2022	2023	%	2023/2022
111	Pije joalkoolike të pa s.d.t.	56,935	25,589	12.9	0.4
041	Grure dhe meslin, të pabluar	30,303	25,554	12.9	0.8
692	Kontejnerë metalikë për ruajtje ose transport	11,779	15,577	7.8	1.3
081	Ushqim për kafshë (pa përfshi drithëra të pafabrikuara)	11,493	15,024	7.6	1.3
421	Vajra dhe yndyra vegjetale, të përpunuara	15,692	12,888	6.5	0.8
044	Misri (pa përfshirë misri i ëmbël), i paplotësuar	10,959	6,975	3.5	0.6
001	Kafshë të gjalla përveç kafshëve të ndarjes në kreun 03	14,270	6,874	3.5	0.5
641	Letër dhe karton prej letre	5,686	5,051	2.5	0.9
048	Përgatitjet nga drithërat dhe përgatitjet nga mielli	13,268	4,642	2.3	0.3
662	Materiale ndertimore prej argjile	9,643	4,635	2.3	0.5
	Të tjera	192,037	75,928	38.2	0.4
	Total importet	372,065	198,736	100.0	0.5

Rrjedhat e eksportit dhe të importit gjatë vitit 2023

Në këtë publikim të statistikave të tregtisë së mallrave janë dhënë më gjerësisht shumë sqarime në detaje për atë se çka eksporton vendi ynë në tregun e jashtëm dhe çka importon nga tregu i jashtëm.

Tregtia e mallrave në vitin 2023 kishte deficitin tregtar në vlerë prej 5,1 miliard Euro, që tregojnë për një deficit tregtar më të larët për (7.1%) krahasuar me vitin 2022, ku edhe në këtë vit kemi bilanc negativ. Totali i eksporteve në këtë vit ishte 863,1 milion Euro, ndërsa importi 5,9 miliard Euro. Eksporti mbulon importin për vetëm 14.6%.

Duke krahasuar të dhënat e eksporteve për mallrat Kosovare gjatë vitit 2023 me ato të vitit 2022 shifrat tregojn se kemi një rënie vjetore për (-6.2%), rënje e cila ka edhe më tutje bilancin negativ tregtar të Kosovës.

Gjatët kësaj periudhe rritje të eksporteve kishte në këto grupe:., artikuj prej guri, allçie, prod. qeramike dhe qelqi në vlerë rreth 31,1 milionë Euro (krahasuar me 30,4 milionë Euro ose 3.6% e eksporteve të përgjithshme me rritje prej 2.2%), tekstil dhe artikuj tekstili në vlerë rreth 41,2 milionë Euro (krahasuar me 31,6 milionë Euro ose 4.8% e eksporteve të përgjithshme me rritje prej 30.4%), letër dhe artikuj prej letre në vlerë rreth 11,7 milionë Euro (krahasuar me 11,2 milionë Euro ose 1.4% të eksporteve të përgjithshme me rritje prej 4.3%), makineri, pajisje mekanike dhe elektrike në vlerë rreth 35,2 milionë Euro (krahasuar me 30,8 milionë Euro ose 4.1% e eksporteve të përgjithshme me rritje prej 14.4%), ushqime të përgatitura, pije, pije alkoolike dhe duhan në vlerë rreth 90,8 milionë Euro (krahasuar me 69,6 milionë Euro ose 3.0% e eksporteve të përgjithshme me rritje prej 30.5%), produkte të industrisë kimike në vlerë rreth 24,6 milionë Euro (krahasuar me 20,4 milionë Euro ose 2.8% e eksporteve të përgjithshme me rritje prej 20.3%).

Eksportet sipas seksioneve në këtë vit kishin rënje në këto grupe: artikuj të ndryshëm të prodhuar në vlerë rreth 152,4 milionë Euro (krahasuar me 179,7 milionë Euro ose 17.7% e eksporteve të përgjithshme me rënie prej -15.2%), lëkurë dhe artikuj prej tyre në vlerë rreth 6,5 milionë Euro (krahasuar me 9,4 milionë Euro ose 0.8% e eksporteve të përgjithshme me rënie prej -30.7%), druri dhe artikuj druri në vlerë rreth 14,4 milionë Euro (krahasuar me 15,6 milionë Euro ose 1.7% e eksporteve të përgjithshme me rënie prej -7.5%), produktet minerale në vlerë rreth 52,1 milionë Euro (krahasuar me 103,1 milionë Euro ose 6.0% e eksporteve të përgjithshme me rënie prej -49.9%), plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre në vlerë rreth 119,7 milionë Euro (krahasuar me 127,9 milionë Euro ose 13.9% e eksporteve të përgjithshme me rënie prej -6.5%), metalet bazë dhe artikujt prej tyre në vlerë rreth 192,4 milionë Euro (krahasuar me 212,8 milionë Euro ose 22.3% e eksporteve të përgjithshme me rënie prej -0.8%),

Trend pozitiv të rritjes së eksporteve nga 2013-2023, kanë pas këto grupe të seksioneve: produkte bimore nga 15,4 milionë Euro në 34,1 milionë Euro, ushqime të përgatitura, pije, pije alkoolike dhe duhan nga 19,3 milionë Euro në 90,8 milionë Euro, plastikë, gome dhe artikuj prej tyre nga 18,2 milionë Euro në 119,6 milionë Euro, artikuj të ndryshëm të prodhuar nga 2,6 milionë Euro në 152,4 milionë Euro, etj.

Të dhënat e tregtisë së mallrave për Importin e Kosovës në vitin 2023 kanë shënuar një rritje vjetore rreth (4.9%) duke krahasuar me vitin paraprak 2022.

Rritje te importet sipas seksioneve janë vërejtur në këto grupe: mjetet e transportit të ndryshëm në vlerë rreth 591,0 milionë Euro (krahasuar me 409,7 milionë Euro ose 10.0% e importeve të përgjithshme me rritje prej 44.3%), tekstil dhe artikuj tekstili në vlerë rreth 317,0 milionë Euro (krahasuar me 267,1 milionë Euro ose 5.4% e importeve të përgjithshme me rritje prej 18.7%), artikuj të ndryshëm të prodhuar në vlerë rreth 158,0 milionë Euro (krahasuar me 146,2 milionë Euro ose 2.7% e importeve të përgjithshme me rritje prej 8.0%), makineri, pajisje mekanike dhe elektrike në vlerë rreth 676,6 milionë Euro (krahasuar me 624,8 milionë Euro ose 11.4% e importeve të përgjithshme me rritje prej 8.3%), kafshë të gjalla, produkte me origjinë kafshe në vlerë rreth 282,4 milionë Euro (krahasuar me 280,2 milionë Euro ose 4.8% e importeve të përgjithshme me rritje prej 0.8%), ushqime të përgatitura, pije, pije alkoolike dhe duhan në vlerë rreth 718,2 milionë Euro (krahasuar me 653,1 milionë Euro ose 12.1% e importeve të përgjithshme me rritje prej 10.1%), veshmbathjet e këmbëve (këpucë dhe pjesët e artikujve të tillë) në vlerë rreth 66,0 milionë Euro (krahasuar me 53,9 milionë Euro ose 1.1% e importeve të përgjithshme me rritje prej 22.3%), produkte të industrisë kimike në vlerë rreth 409,4 milionë Euro (krahasuar me 403,0 milionë Euro ose 6.9% e importeve të përgjithshme me rritje prej 1.6%), instr.optike,mjekësore,fotog. muzikore etj. në vlerë rreth 67,2 milionë Euro (krahasuar me 64,8 milionë Euro ose 1.1% e importeve të përgjithshme me rritje prej 3.8%).

Gjatët kësaj periudhe rënie të importeve kishte në këtë grup: produkte minerale (lëndët djegëse) në vlerë rreth 862,1 milionë Euro (krahasuar me 1,0 miliardë Euro ose 14.6% e importeve të përgjithshme

me rënie prej -17.5%), plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre në vlerë rreth 345,2 milionë Euro (krahasuar me 384,2 milionë Euro ose 5.8% e importeve të përgjithshme me rënie prej -10.1%), metale bazë dhe artikuj prej tyre në vlerë rreth 591,6 milionë Euro (krahasuar me 593,4 milionë Euro ose 10.0% e importeve të përgjithshme me rënie prej -0.3%), artikuj prej guri, allçie, prod. qeramike dhe qelqi në vlerë rreth 190,5 milionë Euro (krahasuar me 195,0 milionë Euro ose 3.2% e importeve të përgjithshme me rënie prej -2.3%), letër dhe artikuj prej letre në vlerë rreth 82,9 milionë Euro (krahasuar me 86,4 milionë Euro ose 1.4% e importeve të përgjithshme me rënie prej -4.0%), druri dhe artikuj nga druri në vlerë rreth 117,8 milionë Euro (krahasuar me 124,2 milionë Euro ose 2.0% e importeve të përgjithshme me rënie prej -5.2%), yndyrërat në vlerë rreth 43,8 milionë Euro (krahasuar me 61,1 milionë Euro ose 0.7% e importeve të përgjithshme me një rënie prej -28.3%). Trend pozitiv të rritjes së importeve nga 2013-2023, kanë pas këto grupe të seksioneve: ushqime të përgatitura, pije, pije alkoolike dhe duhan nga 328,0 milionë Euro në 718,2 milionë Euro, produkte të industrisë kimike nga 190,3 milionë Euro në 409,4 milionë Euro, plastikë, gome dhe artikuj prej tyre nga 148,1 milionë Euro në 345,2 milionë Euro, metale bazë dhe artikuj prej tyre nga 247,2 milionë Euro në 591,7 milionë Euro, etj.

Tregtia e jashtme e mallrave me vendet e BE-së-27

Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së-27 arritën në 278,7 milion Euro, ose rreth (32.3%) e eksporteve të përgjithshme, me një rënie prej (-10.6%). Partnerët kryesor për eksportin e mallrave në BE janë: Gjermani (10.8%), Italia (4.5%), Holanda (3.2%), etj.

Sipas kapitujve pjesëmarrje më të lart nga vendet e BE-së kanë te këto grupe të eksporteve: plastika dhe artikujt prej tyre 70,3 milionë Euro ose (25.2%), mobilieritë: krevatet, dyshekët, mbajtëset e dyshekëve dhe shtresa të ngjashme të mbushura llambat dhe pajisje ndriçimi, jo të përfshira diku tjetër 26,7 milion Euro, ose rreth (9.6%), artikuj prej hekurit dhe çeliku 24,0 milion Euro, ose rreth (8.6%), pijet, pije alkoolike dhe uthlla 12,3 milionë Euro ose (4.4%), perlat natyrale apo të kultivuara, gurët e çmuar apo gjysëm të çmuar, metalet e çmuara, bizhuterit dhe monedhat e vjetra 11,1 milionë Euro ose (4.0%), etj.

Vendet e BE-së mbulojnë pjesën më të madhe të importeve të përgjithshme të Kosovës.

Importet e Kosovës nga vendet e BE-së-27 ishin rreth 2,5 miliard Euro, ose (43.0%) e importeve të përgjithshme, me një rritje prej (6.5%). Importet me pjesëmarrje më të lart ishin nga: Gjermania (12.8%), Greqia (5.6%), Italia (5.2%), Polonia (2.6%) dhe Sllovenia (2.2%), etj.

Importet me pjesëmarrja më të lart ishin te këta kapituj: mjetet e transportit të ndryshëm ku arritën 503.1 milion Euro ose rreth (19.8%), lëndët djegëse minerale, vajrat minerale dhe produktet e distinitimit të tyre; substancat bituminoze; dyllet minerale ku arritën 298,4 milion Euro ose rreth (11.7%), etj.

Tregtia me vendet e CEFT-së

Gjatë vitit 2023 eksportet e Kosovës me vendet CEFT-së arritën në 343,7 milion Euro, ose (39.8%) të eksporteve të përgjithshme, ku kishte rritje prej (3.0%). Partner kryesor për eksport në vendet e CEFT-së janë: Maqedonia (14.1%), Shqipëria (13.3%), Serbia (5.8%) dhe Mali i zi (5.2%).

Sipas kapitujve pjesëmarrje më të lart nga vendet e CEFT-së kanë te këto grupe të eksporteve: artikujt prej hekuri dhe çelik ku arritën në 58,0 milionë Euro, ose rreth (16.9%), pijet, pijet alkoolike dhe uthllat ku arritën 37,4 milionë Euro, ose rreth (10.9%), hekuri dhe çelik ku arritën në 34,6 milionë Euro, ose rreth (10.1%), lëndët djegëse minerale, vajrat minerale dhe produktet e distinitimit të tyre; substancat bituminoze; dyllet minerale ku arritën në 27,6 milion Euro, ose rreth (8.0%), etj.

Ndërsa, importet nga vendet e CEFT-së në vitin 2023, arritën në 926,7 milionë Euro, ose (15.7%) të importeve të përgjithshme, me një rënie prej (7.4%). Vendet me pjesëmarrje më të lart për import ishin: Shqipëria (5.5%), Maqedonia (5.3%) dhe Serbia (3.4%). Importet me pjesëmarrja më të lart ishin te këta kapitujt: hekuri dhe çelik ku arritën në 163,1 milion Euro, ose rreth (17.6%), lëndët djegëse minerale, vajrat minerale dhe produktet e distinitimit të tyre; substancat bituminoze; dyllet minerale. ku arritën në 145,3 milion Euro, ose rreth (15,7%), kripërat, sulfuret, oksidet, gurët, materialet suvatuese, gëlqere dhe çimento, ku arritën në 73,1 milion Euro, ose rreth (7.9%) etj.

Tregtia me vendet e tjera të botës

Eksportet e Kosovës me vendet tjera arritën në 241,0 milion Euro, ose (27.9%). Si partner më të rëndësishëm nga këto vendet për eksport janë: SH.B.A (12.3%), Zvicra (8.8%).

Ndërsa importet e Kosovës me vendet tjera arritën në 2,4 miliardë Euro, ose (41.4%). Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin: Turqia (14.8%) dhe Kina (11.0%).

Shpjegime metodologjike

Statistikat e tregtisë së jashtme - shënime metodologjike
Burimet

Statistikat e tregtisë përbëhen kryesisht nga dokumentacioni i dorëzuar tek autoriteti doganor nga importuesit apo eksportuesit (ose agjentet e tyre). Ky dokument është Dokument Unik Doganor (DUD), i cili përdoret për qëllime të zhdoganimit. Informatat nga dokumenti barten ne sistemi informativ doganor.

Përgjegjësitë për mbledhjen, përpilimin dhe publikimin e të dhënave

Administrata doganore është përgjegjëse për mbledhjen, futjen dhe përpunimin e të dhënave të deklaratës doganore. Të dhënat në fushën e statistikave që regjistrohen në DUD, raportohen në baza mujore nga Administrata Doganore, në ASK, në mënyrë elektronike.

ASK-së është përgjegjës për përpunimin dhe publikimin e të dhënave të tregtisë së jashtme. Këto statistika përfshijnë të dhënat sipas llojit të procedurave doganore. Puna shtesë përfshinë korrigjimin dhe miratimin e të dhënave doganore.

Përfshirja

Statistikat e tregtisë së jashtme nuk përfshijnë importet dhe eksportet e mallrave të përkohshme, të cilat në gjendje të pandryshuar do të kthehen pas një kohe të caktuar, siç janë shërbimet, riparimet, parat në kuptimin e rrogave, paraja në ari, furnizimi i veturave kosovare jashtë vendit me derivate, importi i mallrave për zyrat ndërlidhëse dhe misioneve tjera diplomatike në Kosovë, bagazhi personal i udhëtarëve, mostrat komerciale dhe pakot postare me vlerë të ulët.

Sistemi i regjistrimit

Statistikat e tregtisë së jashtme janë të përpiluara sipas sistemit "të veçantë" (definicioni lehtësues) të regjistrimit të tregtisë ndërkombëtare. Sipas këtij sistemi importet dhe eksportet janë të regjistruara, në kohën kur mallrat lëvizin nëpër territor me qarkullim të lirë, e kjo është, pjesa brenda ku mallrat mund të shiten pa kufizime doganore. Definicioni lehtësues nënkupton që përveç transaksionit të rregullt të eksportit dhe importit, është i përfshirë edhe përpunimi i jashtëm dhe i brendshëm.

Eksportet e veçanta përfshijnë eksportet e mallrave: eksportet pas përpunimit të brendshëm, eksportet për përpunim të jashtëm dhe eksportet që nuk regjistrohen ne dogana.

Importet e veçanta përbëhen nga importet e mallrave nga: Importet për përpunim të brendshëm(S.S), Importet pas përpunimit të jashtëm, Importet që nuk regjistrohen ne dogana.

Të përjashtuara janë mallrat që janë në transit.

Vlerësimi

Për importe, përdoret vlera cif (duke përfshirë koston, sigurimin dhe transportin e mallrave në pikën hyrëse në Kosovë). Për eksporte përdoret vlera fob (i lirë në bord). Ky është çmimi i mallrave të blerë jashtë vendit, përfshirë këtu paketimin, transportin brenda shtetit, çmimin për ngarkim, sigurimin si dhe shpenzimet tjera të cilat shfaqen kur mallrat vendosen në anije për eksportim, në aeroplan apo barten në zona të largëta. Vlera e faturës rillogaritet në vlerën e kufirit kosovar, duke shtuar apo zbritur, tërësisht apo pjesërisht, shpenzimet e transportit, ngarkimit, shkarkimit, të cilat varen nga kushtet e furnizimit të caktuara në kontratë.

Vlera përjashton:

" çdo shumë të pranuar nga eksportuesi gjatë rrugës së rifondimit, rikthimit të pagesës doganore, subversionimit apo nga ndonjë ndihme tjetër.

" çdo obligim të huaj doganor apo ndërrim të transportit të mallrave përveç në pikën doganore apo në pikën e eksportimit.

Vlera është në euro. Për transaksionet ku vlera është dhënë në një valutë tjetër, këmbimi në euro bëhet duke përdorur kursin javor të këmbimit valutë.

Periodha e referimit

Muaji kalendarik është periudhë themelore për t'i mbledhur të dhënat. Duke u bazuar në të dhënat doganore, data e dorëzimit të deklaratës doganore apo datat tjera të vlefshme për implementimin e rregullave doganore, janë koha për t'i regjistruar transaksionet e importit/eksportit.

Njësitë e sasisë

Sasia e mallrave të importuara dhe eksportuara tregohet në peshë neto, në qoftë se mund të caktohet, duke marrë parasysh natyrën e produktit si dhe në njësi plotësuese kur përshkruhet nga nomenklatura e tarifës doganore.

Pesha neto është njësi e zakonshme e sasisë së dhënë. Pesha e kontejnerëve, valixheve, qypave dhe materialeve paketues, janë të përjashtuara.

Njësitë tjera të sasisë përdoren për disa mallra më të rëndësishëm si, kafshë të gjalla, motorët e automjeteve, pajisjeve vendore, orëve, rrobave (ku si njësi matëse përdoret numri), këpucë (ku përdoret numri i palëve), mbështjellës për dysheme (ku përdoret metri katror) dhe pijet (ku përdoret vëllimi).

Shtetet partnere

Në këtë publikim, importet janë të regjistruara sipas vendit të origjinës (si e kundërta e vendit të destinimit). Mallrat e marra ose të prodhuara në një vend me prejardhje po nga i njëjti vend. Një produkt në prodhimin e të cilit janë të përfshira dy a më tepër vende, si vendi i origjinës, konsiderohet vendi në të cilin është bërë përpunimi i fundit i rëndësishëm. Paketimi, ripaketimi, klasifikimi nuk konsiderohen si procese prodhuese.

Eksportet janë të klasifikuara sipas vendit të destinimit të fundit. Destinimi i fundit i mallrave konsiderohet shteti i fundit për të cilin mallrat janë dedikuar. Kjo nuk do të thotë se është shteti ku mallrat do të shkarkohen ose ku do të bëhet konsumi i fundit.

Klasifikimi i shtetit

Nomenklatura e shteteve është klasifikimi i shteteve (gjeonomenklatura), sipas Gazetës Zyrtare të Komisionit Evropian, të publikuar çdo vit. Që nga janari 1999, përdoret sistemi ISO alfa 2 shifror i Kombeve të Bashkuara, ku secili shtet identifikohet me shifër të përbërë prej dy shkronjash.

Klasifikimi i mallrave

Statistikat mblidhen duke përdorur Nomenklaturën e Kombinar (NK) 8 shifror - tarifave dhe nomenklaturave statistikore të BE. Kjo nomenklaturë çdo vit udhëhiqet dhe azhurnohet nga komisioni në bashkëpunim me shtetet anëtare. NK përputhet me sistemin 6 shifror të Sistemit të Harmonizuar të Përshkrimit dhe Kodimit të Mallrave (SH) - Nomenklatura e Këshillit Doganor për Bashkëpunim cila përdoret në tërë botën për aplikimin e tarifave doganore dhe përpilimin e statistikave të tregtisë së jashtme. NK përmban rreth 10,400 8- shifra nën-krerë, 6 shifrat e para të të cilit janë të njëjta me shifrat e Sistemit të Harmonizuar (SH).

Klasifikimi standard i tregtisë (KST), versioni i ripunuar nr. 3 (SITC Rev 3), është zhvilluar nga Kombet e Bashkuara për krahasueshmëri të avancuar ndërkombëtare për statistika të tregtisë së jashtme.

Klasifikimi Standard i Tregtisë së Jashtme (KSTJ) versioni i ripunuar nr. 3 përmban rreth 3,100 krerë themelor (5- shifrore). Këto janë të kombinuara në 261 grupe (3-shifrore), 98 divizione (2-shifrore) dhe 10 seksione (1-shifror). Për shembull, Seksioni 6 (mallrat e fabrikuara të klasifikuara kryesisht sipas materialit) përbëhen nga 9 Divizione, 61 deri në 69. Divizion 64 (letër, karton dhe artikujt prej tyre) përbëhen nga dy grupe, 641 dhe 642, të cilat bashkërisht përbëjnë 72 krerë themelor, siç janë 642.94 (palloma, peshqirë, mbulesa për tavolina, dhe të ngjashme).

KSTJ versioni i ripunuar nr. 3 është identik me strukturën e Sistemit të harmonizuar. Secila kategori e KSTJ (duke përfshirë të gjithë krerët themelor) është ekuivalent me kombinimin e krerëve të SH (prandaj edhe të kombinimit të krerëve të NK).

Publikimi i të dhënave

Të dhënat mujore janë të dhëna preliminare dhe publikohen 24 ditë pas muajit referues.

Të dhënat vjetore publikohen në qershor si të dhëna përfundimtare.

Të dhënat e publikuara të statistikave të tregtisë së jashtme janë edhe në ASK-Data si:

Të dhëna mujore: <http://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pxweb/sq/askdata/> dhe si

Të dhëna vjetore: <http://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pxweb/sq/askdata/>

Agjencia e Statistikave te Kosovës: Përshkrim i shkurtër

Agjencia e statistikave të Kosovës është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011 si dhe Ndryshim Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-058 i cili ka hyrë në fuqi me 17.01.2019. Programi i Statistikave Zyrtare, 2018/2022 është në implementim për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë *strukture organizative: Departamentet prodhuese; Departamenti i statistikave ekonomike, Departamenti i llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit, dhe Departamenti i statistikave sociale. Departamentet mbështetëse; Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës. Ne kuadër të Agjencionit veprojnë edhe; Zyrrat Rajonale; Gjakovë, Gjiçan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj.*

Të punësuar janë gjithsej 156 punëtorë, prej tyre, 115 në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrrat Rajonale, 41 Agjencioni ka këtë *strukture kualifikuese*, 123 me shkollim universitar, 15 me shkollim të lartë, ndërsa 18 me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikave të shteteve në rajon.

Agjencia e Statistikave të Kosovës mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njësisive raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruet terreni nga Zyrrat Rajonale etj.

Në vitin 2011 është realizuar me sukses projekti i Regjistrimit të Popullsisë Ekonomike Familjar dhe Banesave, ndërsa në vitin 2014 është realizuar po ashtu me sukses Regjistrimi i Bujqësisë. Rezultatet e fituara nga këto regjistrime do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

Misioni i Agjencionit; të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

Adresa:

AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS

Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë

Telefoni:

+383 (0) 38 200 31 129

Kryeshefi Ekzekutiv:

+383 (0) 38 200 31 112

Fax:

+383 (0) 38 235 033

E-mail:

infoask@rks-gov.net

Ueb-faqe:

<http://ask.rks-gov.net>